

## ANEKSI 17. PARAMETRAT/NORMAT PËR KRERË PËR NDËRTIMIN E AMBJENTEVE PËR MBARËSHTIMIN E KAFSHËVE

### 1. STREHIMET PËR LOPË

Treguesit	Njësia	Parametrat normal
Sipërfaqja	m <sup>2</sup> /krerë	6.0
Vëllimi	m <sup>3</sup> /krerë	15-30
Koefiçenti i ndriçimit natyral		1:10
Gjatësia e shtratit	Metër	2 - 2.4
Gjerësia e shtratit	Metër	1.2 - 1.3
Gjerësia korridorit qëndror	Metër	3 - 4
Gjerësia e korridorit anësor	Metër	0.80
Gjerësia e grazhdit	Metër	0.70
Lartësia (dyscheme-baza e çatisë)	Metër	2.5 - 3

### STREHIMET PËR GJEDHIN NË RRIKJE

Treguesit	Pesha e gjallë /kg				
	100	200	300	400	500
Gjatësia e shtratit në metër (m)	1.5	1.7	1.95	2.15	2.4
Gjerësia e shtratit m	0.55	0.7	0.85	0.95	1.1
Mosha /muaj	deri 3	3-6	7-12	13-24	24-36
Sipërfaqe m <sup>2</sup> / krerë	1.0	2.0	3.0	4.0	5.0

- Sipërfaqe 3 - 4 m<sup>2</sup> / krerë në padoqe.
- Ndërtesa në brëndësi duhet të ketë një pjerësi 2 - 4 % gjatë gjithë gjatësisë së saj.
- Stallat dhe vendepozitimi i plehut organik duhet të ndërtohen 1 - 1.5 km larg qendrave të banuara.

#### Plehërishtet

- Fermat duhet të sigurojnë sipërfaqe të mjaftueshme për depozitimin e plehut sipas normave. Lopa 180 kv/krerë/vit, të imtat 4 kv/krerë/vit, njëhundrakët 30 kv/krerë/vit.
- Në gjedhë për çdo njësi gjedhi, duhet të sigurohen 10 - 15 m<sup>3</sup> volum në plehërishte.
- Përmasat e ambientit të depozitimit të urinës duhet të jetë 11 m gjatësi x 3 m gjerësi x 1.2 m thellësi për stallat tip 50-100 njësi gjedhi.

## 2. STREHIMET PËR SHPENDË

Strehimet ndërtohen në funksion të mënyrave të mbajtjes së shpendëve.

### 2.1 Për një stabiliment në të cilin mbarështohen brojler

**Dimensionet e lokaleve mund të jenë:**

- Gjatësi 60 - 70 metër; gjerësi 12 - 14 metër; lartësi 2.5 - 3 metër;
- Ndriçimi 20 lux / m<sup>2</sup>; dendësia 33/kg peshë e gjallë/m<sup>2</sup>.

**Për 20 000 brojler** dimensionet e lokaleve mund të jenë: gjatësi 100 m, gjerësi 14 m, lartësi 2.5 - 3 m = 1400 m<sup>2</sup>; sipërfaqja e lokalit 1400 m<sup>2</sup>.

**Për 10 000 brojler** dimensionet e lokaleve mund të jenë: gjatësi 70 m, gjerësi 10 m dhe lartësi 2.5 m = 700 m<sup>2</sup>.

**Për 5 000 krerë brojler** krerë dimensionet e lokaleve mund të jenë: gjatësi 35 m, gjerësi 10 m dhe lartësi 2.5 m, sipërfaqja 350 m<sup>2</sup>.

### 2.2 Pula për prodhim vezësh

- Sipërfaqja mesatare rreth 520 cm<sup>2</sup>/krerë;
- Për pulat për prodhim vezësh me mbajtje në bateri dimensionet e lokaleve duhet të jenë: gjatësi 60 - 70 m, gjerësi 12 - 14 m, lartësi 2.5 - 3 m.

**Sistemi i mbarështimit për tokë, tipi familjar,** lokalet ndërtohen me këto parametra:

**Për 100 pula:** gjatësia e strehimit 5 m, gjerësia 4 m dhe lartësia 2 m; sipërfaqja 20 m<sup>2</sup>.

**Për 60 pula:** gjatësia e strehimit 4 m, gjerësia 3 m dhe lartësia 2 m; sipërfaqja 12 m<sup>2</sup>.

### 2.3 Për tufat prindërore

Në mbajtjen në tokë për tufat prindërore lokalet ndërtohen me gjatësi 50 - 80 m, gjerësi 12 - 14 m dhe lartësi 2.5 - 3 m. Sipërfaqja e lokalit 600 - 1120 m<sup>2</sup>.

Furriqet ndërtohen me:

- hapje 20 - 30 cm;
- lartësi 28 - 38 cm dhe
- thellësi 30 - 35 cm.

Për llogaritjen e sipërfaqes për tufat prindërore merret për bazë vëllimi i furikut.

### 3. STREHIMET PËR DERRA

**Objektet që mund të përmbaj një projekt-stabilimenti për rritjen e derrave sipas kategorive janë:**

- Zona e lëvizjes së kafshëve, automjeteve dhe e personelit;
- Stallat për paradosat dhe dosat barrëse, për remont, për harçat dhe ndërzimin;
- Stallat materinet për dosat së bashku me gicat e vegjel që lindin deri në këputje;
- Stallat për derrat në këputje, rritje dhe majmëri;
- Punishte ushqimi, depo, zyra dhe dhoma për punonjësit;
- Plehërishte, depo uji dhe sistem kanalizimi, kabina elektrike;
- Infermeria për kafshet e sëmura.

#### 3.1 Për ambientet/stallat për paradosa, dosa, remont dhe harça

- Numuri i dosave brënda rrethimit/seksionit jo më shumë se 10 krerë;
- Sipërfaqet e lira për paradosat pas fekondimit 1.64 m<sup>2</sup>;
- Sipërfaqet e lira për dosat e mbajtura në grup 2.25 m<sup>2</sup>.

Numri i krerëve që vendoset nëpër seksione llogaritet:

- Për dosat barrëse merret 50 % e numrit të dosave të prodhimit;
- Për dosat e remontit merret 30 % e numrit të dosave të prodhimit.

#### 3.2 Për dosa riprodhuese

- Koeficienti i ndricimit 1:14;
- Gjerësia e korridorit qëndror 1.36 m;
- Gjerësia e kanalit të urinës 0.15 - 0.20 m;
- Fronti i ushqimit për dosat dhe harçin 50 cm /krerë;
- Sipërfaqja e lirë e harçit 6 - 10 m<sup>2</sup>;
- Sipërfaqja e sallës së ndërzimit 12 m<sup>2</sup> ose (2 krerë x 9 m<sup>2</sup>);
- Vëllimi për harç/dosë 8 m<sup>3</sup>;
- Sipërfaqja e padokut për harç 5 m<sup>2</sup> (2 x 2.50 x 1.20).

#### Boksi Kolektiv (Dosa/pritje/ndërzim)

- Hapësira totale 2.43 m<sup>2</sup>/krerë;
- Hapësira e nevojshme për lëvizjen e kafshëve 2.25 m<sup>2</sup>/krerë;
- Hapësira e dyshemesë 1.3 m<sup>2</sup>/krerë;

Gjerësia maksimale e pjesës së “plotë/të mbushur” zgarës së dyshemesë jo më pak se 8 cm; dhe gjerësia e pjesës “bosh” në zgarë 2 cm.

#### 3.3 Për maternitet

Sipërfaqja për krerë (dosa riprodhuese) 2.45 m<sup>2</sup>/krerë

- Koeficienti i ndricimit 1:12;
- Gjerësia e korridorit qëndror 1.36 m;
- Gjerësia e kanalit të urinës 0.15 m;
- Sipërfaqe padoku vetëm për gicat 6 - 7 m<sup>2</sup>/çdo boks;
- Vëllimi i ndërtimit 7 - 8 m<sup>3</sup>/krerë;
- Sipërfaqe padoku vetëm për gicat 6 - 7 m<sup>2</sup>/çdo boks.

### 3.4 Për derrkucat në qumësht

- Dendësia mesatare 0.16 - 0.2 m<sup>2</sup>/krerë.
- 0.15 m<sup>2</sup> për derrat me peshë 10 kg;
- 0.20 m<sup>2</sup> për derrat me peshë 10 - 20 kg;
- 0.30 m<sup>2</sup> për derrat 20 - 30 kg.

Rekomandohet mbajtja në kafaze metalik në formë zgare me dendësinë e mësipërme por, jo më shumë se 10 krerë në kafaz.(faza para fillimit të majmërisë).

### 3.5 Për derrat në majmëri

Sipërfaqja e ndërtimit:

- 0.20 m<sup>2</sup> /krerë për derrat me peshë 10 - 20 kg;
- 0.30 m<sup>2</sup>/krerë për derrat me peshë 20 - 30 kg;
- 0.40 m<sup>2</sup> /krerë për derrat me peshë 30 - 50 kg;
- 0.55 m<sup>2</sup> /krerë për derrat me peshë 50 - 85 kg;
- 0.65 m<sup>2</sup> /krerë për derrat me peshë 85 - 110 kg;
- 1 m<sup>2</sup> /krerë për derrat me peshë 110 kg.

### Të dhëna teknike për stallën e derrave në majmëri

- Koeficienti i ndriçimit 1:10
- Gjerësia e seksioneve 3.13 m;
- Gjerësia e korridorit qëndror 1.2 m;
- Gjerësia e kanalit të urinës 0.15 m;
- Sipërfaqe padoku vetëm për gicat 6-7 m<sup>2</sup>/çdo boks.

### 3.6 Model stabilimenti për mbarështimin e 50 krerë dosave

1. Materniteti (Sipërfaqja + sipërfaqen e korridoreve), 8 m<sup>2</sup> / dosë/ harç
2. Sipërfaqja e gicave dhe derrave në majmëri, 0.85 m<sup>2</sup> / krerë
3. Sipërfaqet e padokut
  - Për dosat barse dhe remont 1.1 m<sup>2</sup> /krerë;
  - Për derrat në majmëri, 0.9 m<sup>2</sup> / krerë.
4. Sipërfaqja e stacionit të ndërzimit 12 m<sup>2</sup>;
5. Rezervuari i ujit 20 m<sup>2</sup>;
6. Klinika e stabilimentit 16 m<sup>2</sup>;
7. Depo dhe punishte ushqimi 30 m<sup>2</sup>;

8. Ambjentet për punonjësit 20 m<sup>2</sup>;
9. Banjat për dezinfektimin e derrave, kanal me përmasat 17.5 m<sup>2</sup>;
10. Depo urine dhe plerishte, 1.5 m<sup>2</sup> / dosë x 50 krerë = 75 m<sup>2</sup>;
11. Sipërfaqe rruge 200 m<sup>2</sup>.

#### 4. STREHIMET PËR TË IMËTA

Nevojat për sipërfaqe trualli strehim dhe funksionim të aktiviteteve:

- Dele dhe kategoritë e tjera 3 m<sup>2</sup>;
- Dhi dhe kategoritë e tjera 3.2 m<sup>2</sup>.

Emërtimi	Peshat e deleve (kg)		
	80 kg	60 kg	40 kg
Sip. m <sup>2</sup> /krerë/dele	1.4	1.3	1.2
Sip. m <sup>2</sup> /qingja < 2muaj	0.25	0.25	0.25
Sip.m <sup>2</sup> /qingja > 2muaj	0.5	0.5	0.5
Vëllimi m <sup>3</sup> /krerë/dele	7-9	7-9	7-9

**Shënim:** Në këto sipërfaqe strehimi që përmenden më sipër, për secilën specie e kategori të kafshëve duhet të shtohet dhe sipërfaqja e nevojshme për koridoret e të ushqyerit dhe anekset e tjera (vënd provizor për mbajtjen e ushqimeve, vëndi i mjelejes, vëndi i vendosjes së paisjeve të qarkullimit të qumështit). Kjo sipërfaqe llogaritet plus 35% të normave të strehimit të tabelës së mësipërme.

Përlllogaritje për sipërfaqen m<sup>2</sup>/krerë për dele plus qingja/dhi plus keca:

$$\text{Sip.m}^2 / \text{dele} + \text{qengja} = \text{Sip.m}^2 / \text{krerë dele} + \{ \text{vlera pjellshmërisë (që mund të jetë 1.2 qingja / dele)} \times 0.5 \text{ m}^2/\text{qengj} \}$$

Sipërfaqja e vëndqëndrimit me shtresë m<sup>2</sup> krerë

- Qengja nën 2 muajsh 0.25 m<sup>2</sup> / krerë;
- Qengja mbi 2 muajsh 0.50 m<sup>2</sup> / krerë;
- Dele 0.70 m<sup>2</sup> / krerë;
- Dele barrëse 1.2 m<sup>2</sup> / krerë;
- Dele me qingja 1.5 m<sup>2</sup> / krerë.